



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE  
REKTORATI  
REKTORI

Nr. 902 prot.

Tiranë më 19/10 2023

VENDIM

Nr. 5, datë 19.10.2023

**“Për shpalljen e periudhës zgjedhore dhe datës së zgjedhjeve, për anëtar të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të Universitetit të Arteve”**

Në zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 39 dhe Neni 99, pika 1 dhe 3, Statutit të UART, Neni 130 si dhe Rregullores së Zgjedhjeve për Këshillin Studentor, neni 5, pas diskutimit dhe caktimit të periudhës zgjedhore dhe datës së zgjedhjeve

**VENDOSI:**

1. Të shpallë periudhën 20 Tetor 2023 – 20 Nëntor 2023, si periudhë zgjedhore për anëtarë të Këshillave Studentorë të Fakulteteve të Universitetit të Arteve. Brenda kësaj periudhe, duhet të respektohen afatet e nevojshme për krijimin e komisioneve përkatëse dhe zhvillimin e fushatës zgjedhore studentore.
2. Të shpallë datën 21 Nëntor 2023, si datë të zgjedhjeve për anëtarë të Këshillave Studentorë, të Fakulteteve të UART.
3. Zgjedhjet studentore do të zhvillohen në përputhje me Rregulloren e Zgjedhjeve të Këshillit Studentor në Universitetin e Arteve, miratuar me Vendim të Senatit Akademik Nr. 26 dt. 24.05.2023.
4. Vendimi u përcillet për zbatim Njësive kryesore të UART për të përzgjedhur dhe shpallur me vendim të dekanit, anëtarët përfaqësues të KIZC dhe 1 (një) përfaqësues për pozicionin e sekretarit jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga data e shpalljes së periudhës zgjedhore, nga listat e studentëve të vetëkandiduar, të cilët regjistrohen në sekretarinë mësimore të fakultetit përkatës.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë si dhe të shpallet në web faqen e Universitetit.

REKTOR

  
Prof. KASTRIOT ÇAUSHI

